

Përmbajtja e portofolit të kualifikimit (2026)

Portofoli i çdo mësimdhënësi të kulturës profesionale, kandidat për çfarëdo kategori kualifikimi, përbëhet nga dy pjesë:

1. Pjesa me të dhënat personale;
2. Pjesa me përmbajtje profesionale;

I gjithë dokumentacioni i portofolit të kualifikimit përgatitet nga kandidati në format elektronik (pdf) dhe dërgohet me e-mail në adresën info.kualifikimi@akafp.gov.al dhe brenda afatit të përcaktuar nga AKAFPK.

I. Pjesa e portofolit me të dhënat personale të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara):

1. Fotokopje e dokumentit identifikues (pasaportë ose kartë identiteti ose leje drejtimi e mjetit) **(e detyrueshme)**.
2. Jetëshkrimin në gjuhën shqipe, sipas formatit të Europass **(i detyrueshëm)**.
3. Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga AKAFPK, me kreditet e fituara ***të paktën 3 kredite/30 kredite për kategorinë “Mësues i kualifikuar”, të paktën 5 kredite/50 kredite për kategorinë “Mësues specialist”, si dhe të paktën 7 kredite/70 kredite për kategorinë “Mësues mjeshtër”*** të akredituara nga ASCAP dhe të njohura nga AKAFPK **(të detyrueshme)**.
4. Certifikatat e trajnimeve të tjera, që lidhen me mësimdhënien ose profesionin, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit **(nëse ka)**.
5. Vërtetime që tregojnë se kandidati është bashkëpunëtor (specialist i jashtëm me kontratë) i AKAFPK **(nëse është i tillë)**.
6. Certifikatën e kategorisë (shkallës) së kualifikimit të fundit që zotëron kandidati për kategorinë “Mësues specialist” dhe “Mësues Mjeshtër” **(e detyrueshme)**.
7. Dëshmitë e titujve/gradave shkencore të fituara **(nëse ka)**.
8. Vlerësimin e performancës së vitit të fundit nga drejtuesi i ofruesit të AFP-së. Dokumenti i vlerësimit duhet të jetë i vulosur e firmosur nga drejtori i ofruesit **(e detyrueshme)**.
9. Vërtetimin e kryerjes, në periudhën e dy viteve të fundit, të paktën 3 (tre) ditë stazh (praktikë) në fushën profesionale përkatëse, në një institucion publik apo biznes privat. Vërtetimi duhet të jetë i vulosur dhe firmosur nga drejtori i ofruesit të AFP dhe nga përfaqësuesi i institucionit/biznesit **(e detyrueshme)**.
10. Dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja **(nëse ka)**.

II. Pjesa me përmbajtje profesionale e portofolit të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara), ku evidentohet edhe emri e mbiemri i kandidatit:

1. Planin e mësimdhënies të një lënde teorike profesionale ose të një moduli të praktikës profesionale, që e jep mësim **(i detyrueshëm)**.

2. Plan-ditarin e një seance mësimore teorike, bazuar në mësimdhënien, me prezencë fizike dhe atë online, ose plan-ditarin e një seance mësimore praktike me prezencë fizike **(i detyrueshëm)**.
3. Formulimin e një objektivi mësimor specifik, teorik ose praktik **(i detyrueshëm)**.
4. Një instrument për vlerësimin e njohurive ose shprehive të nxënësve apo kursantëve (test teorik me të paktën 5 njësi testi të ndryshme ose listë kontrolli për shprehitë praktike me të paktën 5 kritere vlerësimi) **(i detyrueshëm)**.
5. Një material mësimor për nxënësit/kursantët, për një çështje teorike **(një faqe A4)** ose një udhëzues pune për një aftësi praktike **(i detyrueshëm)**.
6. Një prezantim (në PowerPoint) për një çështje teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde dhe jo më shumë se 6 slajde) **(i detyrueshëm)**.

Dokumentet duhet të renditën sipas radhës së renditur më lart dhe në **çdo faqe** të dokumenteve të shënohet si “**footer note**” **emri dhe mbiemri i kandidatit** për kualifikim.

Për arsye të kapacitetit të madh të dokumenteve, çdo kandidat mund t'i dërgojë ato me dy e-mail-e, duke i ndarë dokumentet sipas pjesëve të paraqitura më lart (Pjesa e portofolit me të dhënat personale dhe Pjesa e portofolit me përmbajtje profesionale) ose me më shumë e-mail-e në varësi të numrit të dokumenteve.

Bazuar në pikën 5, të nenit 5 të Udhëzimit Nr.21, dt.27.6.2022, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.3, dt.13.08.2025, dokumentet e listuara më lart, janë të detyrueshme. Mungesa e të paktën njërit prej tyre e skualifikon menjëherë kandidatin nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.